

# Vodafone 4G Mobile Hotspot

## Model R228t

Të dhëna për sigurinë e produktit



të direktivës dhe mund të përdoret më shumë fuqi se sa është e nevojshme.

## Deklarata FCC

### Pajtueshmëria FCC (kur mbështeten bandat e SHBA)

Federal Communications Commission Notice (Shtetet e Bashkuara):

Para se një model pajisjeje me valë të vihet në dispozicion për t'iu shitur publikut, ajo duhet të testohet dhe të certifikohet sipas FCC për të përcaktuar që nuk e kalon limitin e vendosur nga kërkesat qeveritare për ekspozimin e sigurt. Limiti SAR për routerët me valë që punojnë me bateri i ndjekur nga SHBA është 1,6 watt/kilogram (W/kg) për një gram ind. Vlera më e lartë SAR që i raportohet FCC për këtë lloj pajisjeje është në përputhje me këtë limit. Kjo pajisje është në pajtim me pjesën 15 të Rregulloreve FCC. Përdorimi i nënshtrohet kushtit që kjo pajisje të mos shkaktojë interferencë të dëmshme. Kujdes: Ndryshimet ose modifikimet që nuk janë aprovuar shprehimisht nga prodhuesi mund ta bëjnë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për ta përdorur këtë pajisje. SHËNIM: Kjo pajisje është testuar dhe është konstatuar se pajtohet me kufijtë për pajisjet dixhitale të kategorisë B, sipas seksionit 15 të rregullave të FCC-së. Këta kufij janë krijuar për të garantuar mbrojtje të arsyeshme kundër interferencës së dëmshme në instalimet në banesa. Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji radiofrekuece dhe, nëse nuk instalohet dhe nuk përdoret sipas udhëzimeve, mund të shkaktojë interferenca të dëmshme në radiokomunikime. Megjithatë, nuk ekziston asnjë garanci se do të ndodhin interferenca në një instalim të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferenca të dëmshme ndaj sinjaleve të radios apo televizorit, gjë e cila mund të përcaktohet duke fikur dhe ndezur pajisjen; prandaj përdoruesi nxitet që të provojë ta rregullojë interferencën nëpërmjet një ose më shumë masave të mëposhtme:

- Ndryshoni orientimin ose vendin e antenës marrëse.
- Largojeni më shumë pajisjen nga marrësi.
- Lidheni pajisjen në prizën e një qarku të ndryshëm

CQF73JOVDBTA

**LEXONI KËTË INFORMACION SIGURIE PËRPARA SE TË PËRDORNI PAJISJEN. ZBATIMI I KËTYRE PARALAJMËRIMEVE DO T'JU NDIHMOJË QË TË PARANDALONI LËNDIMET NDAJ VETES OSE TË TJERËVE, SI EDHE DËMTIMIN E PAJISJES.**

## Piktogramet dhe simbolet grafike



Lexoni pjesën "Informacione për sigurinë" në këtë manual përdorimi para se ta përdorni pajisjen. Në rast se nuk u përmbaheni paralajmërimeve të sigurisë, kjo mund të sjellë lëndime të rënda.



Mos e përdorni ndërsa drejtoni automjetin



Për rastet e përdorimit në trup, ruani një distancë prej 5mm



Kjo pajisje nuk është prodhuar për t'u përdorur nga fëmijët e vegjël. Nëse e lejoni një fëmijë ta përdorë atë, sigurohuni që fëmija të jetë nën

përdorë atë, sigurohuni që fëmija të jetë nën mbikëqyrje të repta. Kjo pajisje përmban pjesë të vogla që përbëjnë rrezik mbytjeje



Mbaje larg nga stimuluesve kardiakë dhe pajisjeve të tjera mjekësore personale



Fikeni kur kjo kërkohet në spitale dhe ambiente mjekësore



Fikeni kur ju kërkohet në avionë dhe aeroporte



Fikeni në ambiente shpërthyes



Mos e përdorni këtë pajisje kur kaloni rrugën ose kur jeni me biçikletë



Mos e përdorni gjatë furnizimit me karburant ose pranë gazit ose lëngjeve të ndezshme



Mos e hidhni në zjarr këtë pajisje ose baterinë e saj



Shmangni kontaktin me mjetet magnetike



Shmangni temperaturat ekstreme



Shmangni kontaktin me lëngjet, ambient të thatë



Mos u mundoni ta çmontoni



Mos u mbështetni te kjo pajisje për komunikime urgjence



Përdorni vetëm aksesori të miratuar

## Ekspozimi ndaj frekuencave të radios (RF)

Pajisja përmban një transmetues dhe marrës të valëve radio. Kur është e ndezur, pajisja merr dhe transmeton energji RF. Kur jeni duke e përdorur pajisjen, sistemi që merret me lidhjen kontrollon nivelin e energjisë në të cilën transmeton pajisja juaj.

## Koeficienti Specifik i Absorbimit (SAR)

Pajisja juaj me valë është një transmetues dhe

- Lidheni pajisjen në prizën e një qarku të ndryshëm nga ai ku është lidhur marrësi.
- Flisni me shitësin ose një teknik radioje/televizori me përvojë për ndihmë.

## Shpërqendrimi / drejtimi i automjetit

Drejtimet të automjeteve duhet t'i kushtohet në çdo kohë vëmendja e plotë për të ulur rrezikun e një aksidenti. Përdorimi i kësaj pajisjeje gjatë drejtimit të automjetit shkakton shpërqendritje dhe mund të sjellë aksidente. Ju duhet të jeni në pajtim me ligjet dhe rregulloret vendëse që kufizojnë përdorimin e pajisjeve me valë gjatë drejtimit të automjeteve.

## Përdorimi i makinerive

Përdorimit të makinerive duhet t'i kushtohet në çdo kohë vëmendja e plotë për të ulur rrezikun e një aksidenti.

## Përdorimi i produktit

Ju jeni personi i vetëm përgjegjës për mënyrën si e përdorni telefonin dhe për çdo pasojë që vjen nga përdorimi i tij.

Duhet ta fikni gjithnjë pajisjen çdo herë që ndaloheret përdorimi i celularëve. Përdorimi i pajisjes u nënshtrohet masave të sigurisë të projektuara për të mbrojtur përdoruesit dhe mjedisin e tyre.

- Trajtojeni gjithnjë pajisjen dhe aksesorët e saj me kujdes dhe mbajeni atë në një vend të pastër dhe pa pluhur.
- Mos e ekspozoni pajisjen ose aksesorët e saj në flakë të hapura ose në produkte të ndezura të duhanit.
- Mos e ekspozoni pajisjen ose aksesorët e saj ndaj lëngjeve, lagështisë apo lagështirës së lartë.
- Mos e shkundni, hidhni ose mos u përpiqni ta përthyeri pajisjen ose aksesorët e saj.
- Mos përdorni kimikate të forta, tretës ose aerosolë për të pastruar pajisjen ose aksesorët e tij.
- Mos e pikturoni ose lyeni pajisjen ose aksesorët e saj.
- Mos u përpiqni ta çmontoni pajisjen ose aksesorët e saj, vetëm personeli i autorizuar duhet të bëjë këtë.

kapërcejë kufijtë e ekspozimit ndaj valëve të radios të rekomanduara nga udhëzimet ndërkombëtare. Këto udhëzime janë hartuar nga organizata e pavarur shkencore (ICNIRP) dhe përfshijnë kufijtë e sigurisë të përcaktuar për të garantuar mbrojtjen e të gjithë personave, pavarësisht moshës dhe gjendjes shëndetësore.

Udhëzuesi përdor një njësi matëse të njohur si Koeficienti Specifik i Absorbimit ose SAR. Limiti SAR për pajisjet celulare është 2 W/kg për SAR Koke dhe SAR Trupi, dhe 4 W/kg për SAR Gjymtyrësh. Vlera më e lartë SAR për këtë pajisje kur është testuar përputhet me këtë limit.

Maksimumi SAR për këtë model dhe kushtet sipas të cilave ishte regjistruar.		
SAR Trupi (5mm)	LTE Band 38 + WiFi 5GHz	1.69 W/kg*
SAR Gjymtyrësh (0mm)	LTE Band 40 + WiFi 5GHz	3.69 W/kg*

\*Testet bëhen në përputhje me [CENELEC EN50566] [IEC 62209-2] [IEC/IEEE 62209-1528]

### Funksionimi i veshur në trup

Për të siguruar pajtueshmëri me direktivat e ekspozimit të RF, pajisja duhet të përdoret me një minimum prej 5 mm distancë nga trupi.

Në rast se nuk zbatohen këto udhëzime, mund të rezultojë që ekspozimi i RF të tejkalojë limitet përkatëse

temperatura ekstreme, minimum -0°C dhe maksimum +45°C gradë Celsius.

- Kontrolloni rregulloret lokale për hedhjen e produkteve elektronike.
- Mos e mbani pajisjen në xhepin e pasmë sepse mund të thyhet kur uleni.

### Fëmijët

Mos i lini pajisjen dhe aksesoret e saj në një vend të arritshëm nga fëmijët ose mos i lejoni fëmijët të luajnë me to.

Ata mund të dëmtojnë veten ose të tjerët, ose aksidentalisht mund të dëmtojnë pajisjen.

Pajisja përmban pjesë të vogla me tehe të mprehta që mund të shkaktojnë dëmtim apo mund të shkëputen dhe të krijojnë rrezik mbytjeje.

### Shkarkimi elektrostatik (ESD)

Mos i prekni konektorët metalikë të kartës SIM ose kartës së memories.

### Furnizimi me energji

Mos e lidhni pajisjen me furnizimin me energji ose mos e ndizni atë derisa të udhëzoheni për këtë në udhëzimet e instalimit.

### Jastëkët e ajrit

Mos e vendosni këtë pajisje në zonën pranë ose mbi një jastëku ajri ose në zonën e aktivizimit të jastëkut të ajrit. Vendoseni pajisjen në vend të sigurt para se të drejtoni automjetin.

## Situatat emergjente

Kjo pajisje, si çdo pajisje tjetër me valë, punon duke përdorur valë radio, të cilat nuk mund të garantojnë lidhje në të gjitha kushtet. Për këtë arsye, kurrë nuk duhet të mbështeteni vetëm te një pajisje me valë për komunikimet e emergjencës.

## Nxehja e pajisjes

Pajisja mund të nxehet gjatë karikimit dhe përdorimit normal. Mos e përdorni nëse nxehet tepër.

## Siguria elektrike

### Aksesorët

Përdorni vetëm aksesorët dhe karikuesit e miratuar. Mos e lidhni me produkte ose pajisje të papajtueshme. Bëni kujdes të mos prekni ose lejoni që objekte metalike, si monedhat apo mbajtëset e çelësave, të kontaktojnë ose të krijojnë qark të shkurtër me terminalet e baterisë, karikuesin, pikën e karikimit të pajisjes ose çdo kontakt apo aksesor elektrik. Mos e prekni pajisjen me duar të lagura. Mos e prekni kordonin e energjisë me duar të lagura ose mos e shkëputni karikuesin duke tërhequr kordonin. Kjo mund të rezultojë në goditje elektrike.

### Lidhja në një makinë

Kërkoni këshilla profesionale kur lidhni një pajisje me sistemin elektronik të automjetit.

### Produktet me defekt dhe të dëmtuara

Mos u përpuni të çmontoni pajisjen ose aksesorët e saj. Vetëm personeli i kualifikuar duhet të kryejë shërbimin ose riparimin e pajisjes ose aksesorëve të saj. Nëse pajisja ose aksesorët e saj bien në ujë ose lëngje të tjera, shpohen ose rrëzohen nga lartësi e madhe, mos i përdorni derisa t'i keni dërguar për kontroll në një qendër shërbimi të autorizuar.

### Trajtimi dhe siguria e baterisë

Fikeni gjithmonë pajisjen dhe shkëputeni kabllon para se të hiqni baterinë. Përdorni vetëm baterinë dhe kabllon e dhënë bashkë me pajisjen ose që janë aprovuar nga prodhuesi për t'u përdorur me pajisjen tuaj. Përdorimi i baterive dhe i karikuesve të tjerë mund të ietë i reziqshëm.



## Hedhja dhe riciklimi

1. Kur në këtë produkt ndodhet simboli i koshit me kryq, kjo do të thotë që produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.
2. Të gjitha produktet elektrike dhe elektronike duhet të hidhen veçmas nga mbetjet e tjera, në pikat e grumbullimit të caktuara nga qeveria ose autoritetet vendore.
3. Hedhja e duhur e pajisjes suaj të vjetër do të ndihmojë në parandalimin e pasojave të mundshme negative ndaj mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

## Informacion për softuerin

Versioni i softuerit të produktit është R228t\_IZ\_02.00 ose më i ri. Do të vihen në dispozicion përditësime softueri për ta bërë produktin më të përdorshëm.

## Përditësimet e softuerit

Duke vazhduar përdorimin e kësaj pajisjeje, ju tregoni se keni lexuar dhe bini dakord me përmbajtjen e mëposhtme: Për të ofruar shërbim më të mirë, kjo pajisje do të kontrollojë për/marrë përditësime softueri automatikisht nga Vodafone dhe partnerët e tij pas lidhjes me internetin.

Ky proces mund të përdorë të dhënat celulare dhe kërkon akses në identifikuesin unik të pajisjes suaj (IMEI/SN) dhe ID-në e rrjetit të ofruesit të shërbimit (PLMN) për të kontrolluar nëse pajisja ka nevojë të përditësohet. Kini parasysh se as Vodafone dhe as partnerët e tij nuk do ta përdorin informacionin e IMEI/SN për të të identifikuar ty personalisht, por kjo bëhet vetëm për planifikimin/ menaxhimin e përditësimeve të softuerit.

Kjo pajisje mund të përdoret në të gjitha vendet evropiane. Frekuenca 5150-5250 MHz (1) e Wi-Fi 5G mund të përdoret brenda ndërtesave dhe jashtë vetëm kur pajisjet nuk do të vendosen në një instalacion të fiksuar ose në trupin e jashtëm të mjeteve rugore, në një infrastrukturë fikse ose në një antenë të jashtme të fiksuar. Frekuenca 5250-5350 MHz (1) e Wi-Fi 5G mund të përdoret vetëm brenda ndërtesave. Dhe banda 5470-5725 MHz (1) e Wi-Fi 5G nuk mund të përdoret në mjete rugore, trena, avionë ose UAS (Sistem Avioni pa Pilot) për shtetet e mëposhtme:

Përdorimi i papërshtatshëm i baterisë mund të shkaktojë zjarr, shpërthim ose reziqe të tjera. Nëse mendoni se bateria është dëmtuar, mos e përdor më, por çojeni në pikën e servisit për testim.

Mos e çmontoni dhe mos lejoni që bateria të krijojë qark të shkurtër. Mund të ndodhë qark i shkurtër aksidental nëse kontaktet e baterisë preken nga ndonjë send metalik, si p.sh. çelës, kapëse fletësh apo stilolaps.

Mos përdorni bateri të dëmtuara, që nxjerrin tym apo që rrjedhin.

Mos lejoni që bateria të laget.

Mos e shpini apo shtypni baterinë, as mos lejoni t'i ushtrohet ndonjë trysni apo forcë e jashtme

## Ndërhyrjet

Duhet treguar kujdes kur e përdorni pajisjen në afërsi të pajisjeve personale mjekësore, të tilla si stimuluesit kardiakë dhe aparatet e dëgjimit.

## Stimuluesit kardiakë

Prodhuesit e stimuluesve kardiakë rekomandojnë që të ruhet një distancë minimale prej 15 cm midis një pajisjeje dhe një stimuluesi kardiak për të shmangur një ndërhyrje të mundshme me stimuluesin.

## Pajisjet e dëgjimit

Personat me aparate dëgjimi ose implante të tjera dëgjimi mund të dëgjojnë zhurma interferente gjatë përdorimit të pajisjeve me valë ose kur kanë pranë një të tillë.

Niveli i interferencës varet nga lloji i aparatit të dëgjimit dhe nga distanca nga burimi i interferencës dhe rritja e distancës midis tyre mund ta zvogëlojë interferencën. Mund të konsultoheni edhe me prodhuesin e pajisjes ndihmëse të dëgjimit për të diskutuar alternativat.

## Pajisjet mjekësore


Konsultohuni me mjekun dhe prodhuesin e pajisjes mjekësore për të përcaktuar nëse përdorimi i pajisjes mund të ndërhyjë në funksionimin e pajisjes mjekësore.


## Spitalet

Fikini pajisjet me valë kur kjo kërkohet në spitale, në klinika ose në mjedise të kujdesit shëndetësor. Këto kërkesa janë hartuar për të parandaluar ndërhyrjet e mundshme me pajisjet e ndjeshme mjekësore.

## Avionët

Fikeni pajisjen celulare kur të kërkohet nga personeli i aeroportit ose i kompanisë ajrore.

	BE	BG	CZ	DK
	DE	EE	IE	EL
	ES	FR	HR	IT
	CY	LV	LT	LU
	HU	MT	NL	AT
	PL	PT	RO	SI
	SK	FI	SE	NO
	IS	LI	CH	TR
	UK(NI)			

	Vendet e treta			
	UK			

## Specifikimi

Kjo pajisje radioje funksionon në brezat e frekuencës dhe fuqinë maksimale të radio-frekuencës si më poshtë.

**SHËNIM:** Ky produkt është në përputhje me limitet për energjinë të vendosura nga Bashkimi Evropian. Bandat e frekuencës që pranohen nga produkti ndryshojnë sipas modelit.

Shërbimet	Niveli i energjisë (Maksimum)
GSM 900 MHz	33,0 dBm
GSM 1800 MHz	30,5 dBm
UMTS Band 1 (2100 MHz)	24,5 dBm
UMTS Band 3 (1800 MHz)	24,5 dBm
UMTS Band 8 (900 MHz)	24,0 dBm
LTE FDD Band 1 (2100 MHz)	23,5 dBm
LTE FDD Band 3 (1800 MHz)	23,5 dBm
LTE FDD Band 7 (2600 MHz)	23,5 dBm
LTE FDD Band 8 (900 MHz)	23,5 dBm
LTE FDD Band 20 (800 MHz)	23,5 dBm
LTE FDD Band 28 (700 MHz)	24,0 dBm
LTE TDD Band 38 (2600 MHz)	23,5 dBm
LTE TDD Band 40 (2300 MHz)	23,5 dBm
802.11 b/g/n 2.4GHz band	19,43 dBm
802.11 a/n/ac 5150 – 5350 MHz	19,21 dBm
802.11 a/n/ac 5470 – 5725 MHz	19,04 dBm

Flisni me personelin e kompanisë ajrore rreth përdorimit të pajisjeve me valë në bordin e avionit dhe nëse pajisja juaj ka "modalitetin e avionit", ky duhet aktivizuar para se të hipni në avion.

## **Ambientet shpërthyes**

### **Pikat e karburantit dhe atmosfera shpërthyes**

Në vende me atmosfera mundësisht shpërthyes veproni në përputhje me të gjitha shenjat e afishuara për të fikur pajisjet me valë, si p.sh. pajisjen tuaj ose pajisje të tjera radio.

Zonat me atmosfera mundësisht shpërthyes përfshijnë zonat e rimbushjes me karburant, zonat poshtë kuvertës në varka, godinat e transferimit ose të magazinimit të karburantit ose të kimikateve dhe zonat ku ajri përmban kimikate ose grimca, si p.sh. kokrriza, pluhur ose pluhura metalesh.

### **Detonatorët dhe zonat e shpërthimit**

Fikeni pajisjen me valë kur jeni në një zonë shpërthimi ose në zona ku janë afishuar njoftime për fikjen e pajisjeve radio me "dy drejtime komunikimi" ose të "pajisjeve elektronike" për të shmangur interferencën me operacionet e shpërthimit.

802.11 a/n/ac 5725 – 5875 MHz

13,05 dBm



Këtu Vodafone deklaron se kjo pajisje radio e tipit Vodafone 4G Mobile Hotspot R228t është në përputhje me direktivën 2014/53/EU. Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit të BE-së disponohet në adresën e mëposhtme të internetit:

<http://vodafone.com/R228t/ec-declaration>

### **Vodafone**

Vodafone S.à r.L., 15 rue Edward Steichen, L-2540 Luxembourg, Grand-Duché de Luxembourg

© Vodafone Group 2022. Vodafone dhe Logot Vodafone janë marka tregtare të Vodafone Group. Çdo produkt ose emrat e shoqërive të përmendura këtu mund të jenë marka tregtare të pronarëve përkatëse.